



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE

Udhëzues për aplikim: Thirrja publike për përkrahje të ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për shërbimet e digjitalizimit – Iniciativa për Fuqizim Digjital.

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me projektin “Enabling Income Generation for the Poor”(EnInGeP) nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe zbatuar nga CARE dhe ECIKS.

1. Hyrje

Ftohen ndërmarrjet kosovare të bëhen pjesë e Skemës së Grantëve për Digjitalizim - Iniciativa për Fuqizim Digjital (IFD) dhe të përfitojnë nga shërbimet e subvencionuara të digjitalizimit

2. Qëllimi

IFD ka për qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve për transformim digjital, me qëllim të rritjes së performancës, konkurrueshmërisë dhe qasjes në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

3. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e projektit është 150,000.00€. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Grantet do të ndahen përmes kategorive si në vijim:

- 80% subvencion për ndërmarrjet mikro deri ne 9 punëtorë
- 70% subvencion për ndërmarrjet e vogla 10 – 49 punëtorë
- 60% subvencion për ndërmarrjet e mesme 50 – 249 punëtorë

4. Shërbimet e digjitalizimit dhe madhësia e grantit (vetëm për një shërbim mund të përcaktoheni)

- Marketingu Digjital - Madhësia maksimale e Grantit: 2,500 €
- Burime Njerëzore përmes platformave të licencuara - Madhësia maksimale e Grantit: 2,000 €
- E- Tregtia / Platformat e Shitjes Online- Madhësia maksimale e grantit 3,500 €
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP) - Madhësia maksimale e Grantit: 2,500 €
- Programe të ndryshme automatizimi dhe optimizimi - Madhësia maksimale e grantit 4,000 €

5. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
- Listën e punëtorëve për vitin 2024 të lëshuar nga ATK me emrin e biznesit aplikues në harmoni me NUI (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të dhe do të vlerësohen piket e punësimit të gjinisë femërore. Për bizneset e regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 2025 duhet të sjellin listën e punëtorëve që nga regjistrimi.
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
- Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.
- Gjendjen e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
- Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
- Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit, strukturën organizative të aplikuesit, ndikimin në performancën e ndërmarrjes, dhe aplikimin e energjisë së ripërtërishme dhe ekonomisë së gjelbër, duhet të shkarkohet nga webfaqja e KIESA-s, të përgatitet nga subjekti aplikues dhe të ngarkohet në platformën e-Kosova.
- Aplikacioni, duhet të plotësohet online në eKosova.

Sqarim: Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar më lartë, subjektet aplikuese do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohen për vlerësim.

6. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit nuk mund të tejkalojë tetë (8) muaj që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet dy palëve (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës apo raportit të komisionit monitorues).

7. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Ndërmarrja përfituese pas shërbimit të pranuar nga ofruesi i shërbimeve, obligohet që të paguaj ofruesin e shërbimeve në vlerën totale sipas klasifikimit të shërbimit digjital. Më pas ndërmarrja përfituese do të rimbursohet në bazë të pikës 3 të dhe 4 të këtij udhëzimi.

- NMVM-të që kanë përfituar subvencionim nga skema paraprake e digjitalizimit (IFD), në vitin 2024 nuk mund të përfitojnë në këtë skemë.
- Meqenëse kjo skemë ofron shërbime në fushën e digjitalizimit dhe është bashkëfinancim nga donatorët, të drejtë aplikimi kanë të gjitha ndërmarrjet, pavarësisht nëse kanë përfituar apo do të përfitojnë nga skemat tjera të KIESA-s gjatë vitit 2025.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe, pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Ndryshimi i shërbimit të digjitalizimit mund të bëhet vetëm në koordinim dhe aprovim nga konsulenti i diagnostifikimit.
- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur me pikë më të larta nga komisioni vlerësues varësisht mjeteve të planifikuara.
- Fushë veprimtaria e ndërmarrjes nuk mund të ndryshohet pas hapjes së kësaj thirrje publike
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve të vlerësuara.
- Nuk përkrahën ndërmarrjet që aktivitetin primar dhe sekondar e kanë në sektorin e tregtisë

8. Si të aplikohet?

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT dhe të KIESA:
 - <https://mint.rks-gov.net/>
 - <http://kiesa.rks-gov.net/>
- Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova <https://ekosova.rks-gov.net/677>
- Afati për aplikim: nga data 04.09.2025 deri më datë 24.09.2025
- Informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

9. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë të ndara në dy pjesë: Kriteret sektoriale dhe kriteret sociale.

Kriteret sektoriale: Përparësi do t'u ofrohet ndërmarrjeve prodhuese, që eksportojnë ose kanë potencial për eksport dhe që krijojnë vende të reja pune. Maksimumi i pikëve që mund fitohen është 50 pikë. Ndërsa minimumi i kërkuar është 22.5 pikë. Sektor: Prodhim (20 pikë) / Shërbime (15 pikë) | Eksport (deri më 10 pikë) | Punësim (deri më 20 pikë).

Kriteret Sociale: Përparësi do t'u ofrohet ndërmarrjeve që do të kenë ndikim në punësimin e grave(deri më 10 pikë), të varfërve (deri më 10 pikë) dhe minoriteteve (deri më 6 pikë). Po ashtu përparësi do të kenë ndërmarrjet në pronësi të grave (9 pikë), minoriteteve (4 pikë, dhe atyre që përdorin mjete apo metoda të energjisë së ripërtërishme (5 pikë) dhe që operojnë në rajone jo të zhvilluara (deri më 6 pikë). Maksimumi i pikëve që mund fitohen është 50 pikë. Ndërsa minimumi i kërkuar është 11 pikë.

10. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, në platformën e-Kosova.

Shënim:

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.